



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 7269 prot.

Tiranë, më 02. 6. 2024

Lënda: Kthim përgjigje

z. BESNIK DERVISHI

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Nd.5, Tiranë

I nderuar z. Komisioner,

Në vijim të kërkesës suaj, Nr.1400/1 prot, datë 30.05.2024, me lëndë "Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare", protokolluar pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me Nr.7269 prot., datë 03.06.2024, ku Zyra e Komisionerit ka kërkuar të informohet mbi trajtimin dhe procedurën e ndjekur, si dhe sqarime mbi disponimin e informacionit, ju informojmë se,

Në zbatim të kuadrit ligjor, ende nuk është miratuar lëvizja e fondeve të Muzeut Historik Kombëtar. Deri në momentin e miratimit të procedurës finale, nuk do të ndodh asnjë zhvendosje e fondit.

Gjithashtu, edhe procesi i zhvendosjes së artefakteve të Galerisë Kombëtare të Arteve, të cilat ndodhen në ruajtje në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar, nuk ka ndodhur ende pasi qëndrimi i tyre në ruajtje pranë këtij institucioni do të vijojë deri në momentin që përmbyllen punimet e restaurimit dhe fillimin e procesit të muzealizimit të Galerisë Kombëtare të Arteve.

Falënderit për bashkëpunimin!

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

ALKETA PËRNASKA

